



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 27 shkurt 2015, në mbledhjen e XIV-të (katërmëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi, konsideroj se rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

Ju njoftoj se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur një ditë më parë i kemi shqyrtuar këto pika, dhe kryesisht njëzëri i kemi rekomanduar Kuvendit të Komunës si në konstatime të cilat i morët në hyrje të kësaj mbledhjeje.

z. Bahri Selimi, theksoi, në mbledhjen e fundit të Kuvendit ne Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje kemi kërkuar që për këtë mbledhje pikë e rendit të ditës të jetë edhe, Raport i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, për arsyen e mos përfshirjes së pikës së cekur nuk jemi në dijeni. Sa unë po e vërej drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë i cili është edhe kryesues i atij komisioni nuk është prezentë në këtë mbledhje, andaj nuk jam në dijeni për mungesën e tij apo mos rastësisht ka diçka që nuk duhet të jetë publike sa i përket dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim. Meqë vazhdimisht po thirrëmi në transparencë dhe nëse dëshirojmë të zbatojmë ligjin për transparencë dhe të jemi transparent rreth këtyre çështjeve nuk e besoj se ka diçka të keqe të sillët një raport i tillë në këtë Kuvend ngase ai komision është ngritur nga ky Kuvend dhe është i obliguar t'i raportoj këtij Kuvendi. Andaj ne prapë kërkojmë që në mbledhjen e radhës të përgatitet dhe të përfshihet në rend dite Raporti i komisionit vlerësues për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me atë që parafolësi e kërkoj dhe e ceku, ju njoftoj se drejtori përkatës në mbledhjen e kaluar e ka marrë atë kërkesë të Grupit të LVV-së, jam në dijeni se është duke punuar në këtë drejtim, mirëpo ai në këtë mbledhje mungon me arsye, ndërsa sa i përket asaj që parafolësi e tha se mos rastësisht ka diçka që nuk duhet të bëhet publike, unë nuk e besoj një gjë të tillë, besoj se së shpejti do ta kemi atë raport, andaj e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit të dërguar dhe konstatimeve të KPF-së.

Pas votimit u konstatua se me 30 votë për 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua rendi i propozuar i ditës.

2. Propozimi i vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2014 në vitin 2015 dhe destinimi në kategori të caktuara buxhetore

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, bartja e të hyrave vetanake nga viti në vit është detyrim ligjor ngase të hyrat në muajt nëntor dhe dhjetor të çdo viti për shkaqe procedurale nuk mund të shpenzohen, andaj me ligj është paraparë që ato mjete të mund të barten në vitin vijues në kategori të caktuara buxhetore, mirëpo për më shumë sqarime prezent e kemi drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili fillimisht do të na paraqesë një fjalë hyrëse për këtë propozim vendim.

z. Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë propozim vendim për të cilin konsiderojmë se është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë çështje.

z. Haki Rudari, theksoi, e kam shqyrtuar materialin dhe më janë kujtuar shumë kërkesa të cilat i kemi bërë për të cilat vazhdimisht na është thënë se nuk ka mjete buxhetore për realizimin e tyre, kurse tani në këtë fillim vit na del se ka mjete buxhetore por vetëm mungon vullneti për të investuar dhe për t'iu ndihmuar kategorive të ndryshme, bëjë pyetje, sa janë ndihmuar shoqatat e dala nga lufta nga ana e Komunës së Podujevës, ku në bazë të informatave që kemi përgjigja është pothuajse asnjëherë, pastaj sa janë ndihmuar shoqatat e të burgosurve politikë kategori e cila ka dhënë shumë për këtë vend, e që prapë përgjigja është e njëjtë, ndërsa tani na del se nga të hyrat vetanake në vitin 2014 kanë tepruar 297,039.51 €. Në parim jam për bartjen e këtyre mjeteve për arsye se nuk është mirë që ato mjete të mos shpenzohen, mirëpo jam kundër kësaj forme, jam kundër kësaj që të na mbesin mjete, aq më parë kur kemi nevojën për investime në sektorë të ndryshëm.

Vërejtje tjetër e Grupit të LVV-së qëndron në atë se për Administratën komunale vërehet një shumë e madhe kurse në sektorin e Bujqësisë nuk vërehet bartje e mjeteve, e them këtë duke pasur parasysh që Kryetari i Komunës para disa ditëve e tha se Komuna e Podujevës është më shumë vend bujqësorë, andaj propozoj që një pjesë e këtyre mjeteve të barten në sektorin e bujqësisë për arsye se ka shumë qytetarë të cilët jetën e tyre e sigurojnë nga të ardhurat nga bujqësia.

Pastaj Vërejtje tjetër kemi te Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, kodi 85230 projekte të papërfunduara në vitin paraprak shuma 35,235.68 € sepse nuk specifikohet se për cilat projekte bëhet fjalë. Gjithashtu disa kode për asfaltim të rrugës të cilat në parim i mbështesë por kam vërejtje se ato investime po bëhen kryesisht në vende

nga vijnë anëtarët e partisë e cila udhëheqë në Komunën e Podujevës, çoftë nga Ekzekutivi i Komunës çoftë nga këshilltarët e Kuvendit të Komunës. Vlen të ceket se para disa ditësh kam vizituar Lagjet Stublla dhe Maqani në fshatin Herticë, pastaj Lagja Bajgora në fshatin Surdull, të cilat vërtetë ishin në gjendje të mjerueshme, andaj do të ishte mirë që këto investime të bëhen pikërisht në ato vende ku nevoja për investime është më e madhe. Vërejtja e fundit që ne si Grup e kemi, ka të bëjë me administratën e Arsimit, ne konsiderojmë se arsimi ka nevojë për buxhet më të madh mirëpo kur ne vitin e kaluar kemi ngritur mungesën e transportit të nxënësve, na është thënë se nuk ka mjete për këtë çështje kurse tani edhe për këtë çështje na del se mjete ka por transporti nuk është bërë, për arsyet nuk jemi në dijeni. Pra ne si Grup në parim jemi për bartjen e mjeteve por kundërshtojmë këtë formë dhe këtë mënyrë të bartjes ku investimet bëhen ad-hoc, drejtori parafolës e tha se këto mjete shkojnë në projekte të papërfunduara në vitin 2014, e kjo i bie se paska pasur projekte pa mbulesë.

z. Avni Ajeti, theksoi, parafolësi e ceku se shoqatat e dala nga lufta nuk përkrahen, ndoshta pati paksa të drejtë, mirëpo sa i përket luftëtarëve të UÇK-së ju them me përgjegjësi të plotë se çdo kërkesë të tyre, çoftë për ndërtim të shtëpisë, çoftë subvencione, e të tjera të ngjashme, Kryetari i Komunës gjithherë ju ka dal në ndihmë edhe luftëtarëve të UÇK-së sikurse të gjithë të tjerëve. Nuk e di a është e nevojshme apo jo por unë mund t'ju jap emrat dhe mbiemrat e të gjithë atyre që janë ndihmuar.

z. Haki Rudari, theksoi, vetë fakti që nga të gjitha Grupet e subjekteve politike të përfaqësuara në këtë përberje të Kuvendit ka pjesëmarrës të luftës është element shumë pozitiv, dhe t'ju them të drejtën unë personalisht kam pritur më shumë në këtë aspekt, mirëpo unë nuk përmenda individ por e thash se asnjë prej shoqatave të dala nga lufta nuk janë mbështetur, shembull, në vitin e kaluar kam marr pjesë në përvjetorin e Betejës së Kaçandollit ku me të vërtetë ka qenë një organizim tejte i dobët dhe krejt ajo u bë si pasoj e mungesës së mjeteve financiare, kështu që parafolësi e tha se Kryetari i Komunës i ka ndihmuar individët, por pyetja ime ishte për shoqatat e dala nga lufta, të cilat nuk janë ndihmuar.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, e kuptojmë atë se këto mjete menaxhohen nga Komuna sepse janë të hyra të Komunës, në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar të jetë prezent drejtori i Drejtorisë së Arsimit në mënyrë që të sqarohemi për këtë sektor për arsye se është viti i dytë radhazi që rialokohen mjete për zgjerim dhe renovim të objekteve shkollore përkatësisht të njoftohemi se cilat shkolla janë paraparë të përfitojnë nga kjo bartje e mjeteve, gjithashtu vlen të ceket se në fillim të këtij viti ne kemi marr një raport nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit në të cilin nuk është paraqitur kurrfarë emergjence për ndonjë shkollë të caktuar, kurse për mendimin tim në vitin e kaluar por edhe në këtë vit së paku tri shkolla kanë pasur nevojë emergjente për zgjerim dhe renovim, dhe atë, shkolla "Naim Frashëri" në fshatin Murgull, paralelja e ndarë në shkollën "Luigj Gurraquqi" cikli i ulët dhe shkolla e fshatit Halabak, shkolla të cilat kanë nevojë emergjente dhe për të cilat mendoj se është shumë e padrejtë që asnjëherë nuk janë alokuar mjete për t'i zgjeruar ose rinovuar këto tri shkolla. Drejtori parafolës në fjalën hyrëse e tha se këto mjete destinohen për projekte të papërfunduara në vitin 2014, kurse ne jemi në dijeni se asnjë projekt nuk është lajmëruar si i papërfunduar në vitin 2014 gjë e cila më ka bërë përshtypje dhe për këtë arsye do të dëshiroja të marr sqarime dhe përgjigje nga drejtorët e Drejtorive përfituese nga kjo bartje mirëpo meqë nuk janë prezent këtu nuk di kush mund të na jap përgjigje neve si këshilltarë e që mendoj se kjo mos prezencë e tyre është

papërgjegjësi personale e tyre. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në raportin e bërë në fillim të këtij viti për gjendjen e arsimit në Komunën e Podujevës nuk ka paraqitur kurrfarë projekti çoftë të përfunduar çoftë të pa përfunduar, ndërsa gjendjen në arsim e ka paraqitur si të shkëlqyer, por unë mendoj se në çoftë se do të kishte inspektor serioz dhe po të ishte edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit serioz sigurisht se në tri shkollat e lartcekura nuk do të mund të zhvillohej procesi i mësimi sepse ato objekte janë në gjendje të mjerueshme, kurse asnjëherë drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk i ka paraqitur këto probleme dhe asnjëherë nuk ka kërkuar mbështetje financiare për t'i rinovuar ato shkollat, pra për këto mjete financiare që sot me siguri se do të barten në Arsim nuk kemi sqarime se ku saktësisht destinohen gjë për të cilën unë do të kërkoj sqarime në gjashtëmujorin e parë të vitit. Mendoj se nuk është e drejtë në çoftë se këto mjete nga të hyrat vetanake destinohen për adoptim të ndërtimit të një shkolle, kur e kemi parasysh gjendjen e shkollave të cekura në të cilat shpesh ndodhë të mos mbahet mësim fare sepse nuk ka kushte gjë e cila është edhe përgjegjësi e këtij Kuvendi sepse ne jemi në dijeni për atë kurse nuk ndërmarrim masa për të intervenuar ose për ta orientuar drejtorin përkatës se ku të destinon mjetet. Unë plotësisht do të kisha mbështetur këto bartje të mjeteve buxhetore nëse do të na prezantohej destinimi i tyre me projekte konkrete ashtu si janë prezantuar bartjet në Drejtorinë tjera të përfshira në këtë dokument, andaj me siguri se ky propozim do të miratohet sot mirëpo mendoj se gjendja në ato shkolla duke përfshirë edhe shkollën e fshatit Batllavë do të mbeten në gjendje të njëjtë.

z. Flakron Gashi, theksoi, në këtë propozim vendim ceket shuma prej 297,039.51 € nga të hyrat vetanake për të cilat thuhet se është shumë e mjeteve buxhetore që nuk ka arritur të shpenzohet për projekte të caktuara në vitin e kaluar, mirëpo të mos të harrojmë se buxheti nga të hyrat e Komunës është rreth 1 milion e 400.000 €, kurse shuma e propozuar për bartje arrin afërsisht 30% e shumës totale nga të hyrat vetanake, jemi në dijeni se të gjithë kolegët këshilltarë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës në këtë Kuvend i kanë thurë elozhe për qeverisje të mirë kësaj qeverisje aktuale të Komunës së Podujevës, mirëpo nëse ndokush mund të merr fjalën dhe të justifikon këtë situatë ku rreth 30% e të hyrave vetanake vjetore të Komunës nuk shpenzohen, atëherë mund të debatojmë për cilësinë e kësaj qeverisjeje. Sa i përket destinimit të këtyre mjeteve për paga dhe mëditje në dy shkollat profesionale dhe që drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e ceku se një pjesë e tyre do të destinohet për pagesa të mësimdhënësve për mësimin jo formal e që i bie rreth 15,000.00 €, konkretisht destinohet në ato shkolla për të cilat nëse ju kujtohet, unë kam ngritur shumë shqetësime, e them këtë sepse thuhet që manipulimi më i madh apo mbështetjet politike destinohen për ata profesorë të cilëve iu jepen orë për të mbajtur mësimin jo formal, andaj shpresoj që këto shuma të jenë realisht paga dhe të mos jenë honorarë politikë.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, fillimisht më duhet të them se të gjitha ato gjëra që i cekën parafolësit janë me vend, disa nga kolegët përmendën pothuajse të gjitha kategoritë, për të cilat asnjëherë nuk e mohoj kontributin e të atyre kategorive, mirëpo ajo çka më brengosë mua është fakti se nga asnjë prej kolegëve këshilltarë të këtij Kuvendi që prej fillimit të këtij mandati nuk është ngritur çështja për kategorinë e fëmijëve apo siç njihen si gjenerata e artë, çështje për të cilën mendoj se ne si shtet jemi ndër vendet e vetme në botë që fëmijët nuk kanë përkujdesje dhe nuk kanë ndihmë materiale-financiare nga shteti, andaj konsideroj se është e nevojshme që në një mbledhje të radhës ta kemi si

pikë të rendit të ditës këtë çështje në mënyrë që të debatojmë dhe të mundohemi të gjejmë forma për përkujdesje ndaj kësaj kategorie.

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi përkatësisht bartjes së të hyrave vetanake unë paraprakisht pajtohem me z. Flakron Gashin i cilin e tha se shuma prej 297,039.51 € bartet nga një buxhet i të hyrave vetanake me mbi 1 milion euro, dhe mendoj se kjo çështje është pak sa e tepruar ngase po të ishte buxheti nga të hyrat 10 milion do të ishte pak sa më normale, mirëpo të barten rreth 30% e të hyrave vetanake lirshëm mund të themi me plotë kuptimin e fjalës se kemi të bëjmë me keqmenaxhim të mjeteve buxhetore në vitin 2014. Vlen të ceket se ka pasur shumë kërkesa të këshilltarëve të cilat nuk janë përkrahur me arsyetim se nuk ka mjete buxhetore për t'i realizuar ato. Një rast që dua ta ceku ka të bëjë me shumën 128,000.00 € nga të hyrat në arsim të cilat tani barten, kurse ne kemi pasur kërkesa për transport të nxënësve nga shtëpitë në shkolla dhe anasjelltas, përkatësisht në fshatin Kaçybeg nxënësve iu është ndërprerë transporti pikërisht për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, gjë e cila na është thënë në këtë Kuvend nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit, kurse tani na dalin 128,000.00 € të tepruara nga viti 2014 e që ai transport i nxënësve do të kushtonte rreth 3,000.00 €, pra edhe kjo na bënë të dyshojmë se ose ka menaxhim jo të mirë të mjeteve buxhetore ose nuk ka vullnet t'iu ndihmohet disa kategorive dhe disa lokaliteteve. Pajtohem me shqetësimet e përmendura nga z. Rafet Llapashtica sa i përket disa shkollave të cilat kanë nevojë emergjente për investime përkatësisht për shkollën “Luigj Gurrakuqi” e cila është në gjendje të mjerueshme dhe pa kurrfarë kushtesh për mbajtje të mësimit. Pra nuk dua t'i përsërisë të gjitha ato që parafolësit i ceken mirëpo më bënë përshtypje të keqe mos shpenzimi i mjeteve nga sektori i arsimit përkundër nevojave të mëdha që ekzistojnë në këtë fushë.

z. Hasan Softolli, theksoi, e përkrahi këtë propozim vendim gjegjësisht bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2014 në vitin 2015. Nuk pajtohem me disa parafolës sepse mendoj se realizimi i buxhetit vazhdimisht bëhet me kujdes të madh nga kjo qeverisje lokale, e them këtë duke menduar se politikat e krijuara nga Qeveria e Kosovës sa i përket shfrytëzimit dhe shpërndarjes së granteve ka bërë që Komuna e Podujevës këto mjete qëllimisht t'i kursej dhe që t'i shpenzoi me kujdes në projekte më të rëndësishme. Sa i përket 30% të mjeteve nga të hyrave vetanake të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2014 mendoj se është e arsyeshme kjo ngase nuk është e domosdoshme që të shpenzohen 100% të hyrat vetanake, dhe se jepet mundësia e bartjes së atyre mjeteve të pashpenzuara nga viti në vit, e që mendoj se është e gjë e mirë kjo sepse Komunave iu jepet mundësia që t'i shpenzojnë në kategori të caktuara.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, do të mundohem të jap sqarim rreth këtij propozim vendimi, mjetet të cilat barten janë mjete të inkasuara në muajt nëntor dhe dhjetorë të vitit 2014, mjete të cilat për investime kapitale nuk mund të shfrytëzohen në atë periudhë. Mjetet e inkasuara në muajin nëntor alokohen më 10 dhjetorë kohë kjo kur gjithçka me projekte përfundon, ndërsa mjetet e inkasuara në dhjetor alokohen më 10 janar 2015, pra ato mjete deshëm apo nuk deshëm nuk mund të shfrytëzohen pavarësisht nevojave por është gjë e mirë që ligjvënësit e kanë paraparë që mjetet e tilla të mund të barten në vitin vijues për projekte të papërfunduara në vitin pasues. Sa i përket bartjes së mjeteve në arsim, janë mjete të dedikuara në destinacion të veçantë për kategorinë e pagave për shkollat profesionale dhe nuk mund të destinohen në kategori tjera, shembull për transport të nxënësve, sepse nuk kemi mundësi ligjore

dhe nuk propozoj një gjë të tillë para Kuvendit sepse nuk lejohet, mirëpo mund të barten për shkolla për të cilat janë të dedikuara ato mjete ngase është e drejtë e atyre shkollave që mjetet të shfrytëzohen nga vetë ato shkolla. Sa i përket shumës 110,000.00 € për kapitale, unë jam i bindur se po të ishte kjo shumë 5 herë më e madhe ne bashkërisht do të mund t'i u gjenim vend sepse disa shkolla kanë nevojë për renovime, madje edhe ato që rinovohen para muajit shtatorë e që deri në muajin qershor të vitit vijues prapë kanë nevojë për renovim shtesë, prandaj ne i kemi bartur ato mjete për zgjerimin dhe renovimin e objekteve shkollore ku kemi menduar edhe për ato shtesë, varësisht nevojave, kështu që në cilat shkolla do të investohen ato mjete ju do të jeni në dijeni gjithsesi.

z. Kadri Avdiu, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi, pajtohem me shpjegimet dhe sqarimet e bëra nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në KPF por edhe sot në Kuvend, gjithashtu e kuptoj atë që të hyrat vetanake të inkasuara nga Komuna në dy muajt e fundit të viti paraprak nuk mund të shfrytëzohen brenda atij viti por duhet të barten në vitin vijues me destinim në projekte apo kategori të caktuara, andaj nuk mendoj se për këtë bartje duhet të kemi dilema sepse kjo është në përputhje me dispozitat ligjore.

z. Flakron Gashi, theksoi, desha të ndërlihem rreth sqarimeve që i bëri drejtori para folës, dhe i parashtroj një pyetje atij, si është e mundur që për një shkollë të rinovuar ose të meremetuar të paramendohet prapë të ri rinovimi ose ri meremetimi i saj, gjë për të cilën mendoj se kemi të bëjmë me dy çështje, ose gjendja në arsim është e mirë por nxënësit janë bërë të egër gjë të cilën nuk e besoj sepse është çështje e sistemit të dështuar, ose çështja tjetër që na shpie te auditimi dhe prokurimi sepse jemi në dijeni që Auditori Gjeneral disa herë ka sugjeruar në procedura të prokurimit, për të cilat mendoj se nuk janë në nivelin e duhur, ose ato kompani të cilat i kryejnë ato punime, i kryejnë nën nivel dhe nuk kanë mbikëqyrje të realizimit të atyre projekteve, e që pastaj është e dijjshme se ri meremetimi duhet të bëhet prapë sepse ashtu e dëshiron pazari politik.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, rinovimi dhe zgjerimi i objekteve shkollore bëhet në kohën kur nxënësit janë në pushim vjetor përkatësisht në muajt korrik - gusht. Nëse një projekt ka filluar dhe është implemetuar në muajt qershor - korrik ose korrik – gusht, dhe fillimi i vitit të ri shkollorë pranohet duke vlerësuar se të gjitha objektet janë gjendje të gatshme për zhvillim të procesit mësimorë, së paku kështu e kemi pasur në raportin e Drejtorisë së Arsimit, atëherë ne po dalim kontrast, çështja tjetër, nëse është lidhë një kontratë për zgjerim dhe rinovim të objekteve shkollore, më së largu 30 ditë pas pranimit teknik duhet të bëhet pagesa nga ana e Komunës, atëherë drejtori para folës e tha se këto mjete nuk mund të shfrytëzohen për projekte të vitit 2015 por vetëm për ato projekte të papërfunduara në vitin 2014, ne patjetër duhet të kalojmë në një temë tjetër me qëllim që rasti të sqarohet si duhet, andaj nëse projektet nuk kanë përfunduar atëherë shkollat nuk kanë qenë të përgatitura për mbarëvajtje të procesit mësimorë ashtu si kërkohet me kritere të arsimit për të filluar viti i ri shkollor, por nëse ka përfunduar rinovimi dhe zgjerimi i atyre objekteve shkollore do të thotë se kompanitë paskan punuar pa kontratë dhe tani me këtë bartje duhet të paguhet, dhe nëse punimet janë kryer por nuk është bërë pagesa me kohë atëherë duhet që tani t'i u paguhet edhe dëmshpërblimi me 3.5% kamatë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, çdo diskutim i secilit këshilltarë i cili konsiderohet se është me vend duhet të pranohet dhe të merret parasysh, mirëpo për çështje të tilla mund të them se janë të rregulluara me ligj, përkatësisht të hyrat e muajve nëntor dhe dhjetorë të çdo viti pasues duhet të barten në vitin pasues ngase nuk mund të shpenzohen në atë vit dhe destinimi i tyre duhet të jetë për projekte të papërfunduara në

vitin 2014 në këtë rast, kështu që këto projekte janë të kontraktuara dhe duhet të përfundojnë punimet dhe të bëhen pagesat për punimet e kryera. Sa i përket diskutimeve lidhur me fushën e arsimit, unë plotësisht i përkrahi informatat e këshilltarëve për shkolla të caktuara për të cilat paraqitet nevoja për renovim ose zgjerim, mirëpo për këtë çështje ngritët një komision nga Drejtoria e Arsimit, i cili ka për detyrë të hulumtoj se cilat objekte dhe hapësira shkollore kanë nevojë më të madhe për rinovim ose zgjerim. Gjithashtu me siguri se edhe vërejtjet e bëra sot nga këshilltarët do të merren parasysh në qoftë janë të arsyeshme, por nuk mendoj se kjo shumë e bartjes së mjeteve buxhetore në arsim është shumë e cila mund të zgjidhë shumë probleme në krahasim me numrin e objekteve të cilat kanë nevojë për meremetime, andaj e hedhë në votim këtë propozim vendim.

Pas votimit u konstatua se me 25 vota për, 4 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi i vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2014 në vitin 2015 dhe destinimi në kategori të caktuara buxhetore.

3. Propozimi i vendimit për transfer të mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave në sektorin e arsimit për vitin 2015

z. Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse ku ndër të tjera veçoi, me rastin e miratimit të projektbuxhetit në muajin shtator 2014 unë e kam cekë se në vitin 2015 mund të kemi probleme për paga në sektorin e arsimit. Në dy muajt e fundit kemi vërejtur një minus në paga për arsimin fillor dhe Drejtoria përkatëse ka bërë një analizë ku në bazë të saj ka rezultuar se në arsimin e mesëm ka tepricë të mjeteve buxhetore, andaj kemi bërë një propozim të tillë të cilin e keni para vetës për të cilin nuk mendoj se ka arsye të mos votohet sot ngase jemi të detyruar të tejkalojmë këtë problem, kurse në të ardhmen me siguri se do të bëhen edhe analiza tjera për bartje tjera të kursyera nga programet tjera për këtë kategori.

z. Haki Rudari, theksoi, drejtori parafolës e tha se kemi minus të mjeteve buxhetore në arsimin fillorë, mirëpo unë mendoj se vërejtja më e madhe qëndron te pranimi i kuadrove sepse në forma të ndryshme pranohen kuadro të rinj në arsim madje edhe pa konkurse, andaj konsideroj se si rezultat i gjithë kësaj vie deri te mungesa e mjeteve për paga të mësimdhënësve. Ne në parim e përkrahim këtë propozim vendim përkatësisht bartjen e 38,000.00 €, mirëpo vërejtja jonë si Grup i Lëvizjes Vetëvendosje është se janë duke u pranuar kuadro arsimor jashtë konkursit ku si pasoj kemi tepricë apo edhe minuse të tilla.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ky propozim vendim është i bazuar në dispozitat ligjore përkatëse me të cilat mundësohet që bartja e mjeteve buxhetore të bëhet brenda programeve përkatëse, nëse ne nuk e miratojmë sot këtë bartje sigurisht se një pjesë e mësimdhënësve në arsimin fillorë do të mbetet pa paga. Meqë nuk ka të lajmëruar këshilltarë të tjerë për diskutim, unë e hedh në votim këtë propozim vendim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për transfer të mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave në sektorin e arsimit për vitin 2015.

4. Rishqyrtimi i vendimit për miratimin e kërkesës së z. Sabit Halitit nga Podujeva për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për shkak të parcelizimit të ngastrës kadastrale nr.607-2

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, paraqiti fjalën hyrëse ku ndër të tjera shtoi, në mbledhjen e kaluar është miratuar propozimi i vendimit sipas kërkesës së personit përkatës, mirëpo në kohën e aplikimit parcela përkatëse ka qenë me gjendjen e vjetër të kadastrit, ndërkohë agjencioni i cili ka qenë i kontraktuar nga niveli qendrorë për të bërë incizimin e ri në disa fshatra të Komunës së Podujevës, i ka sjellë të dhënat e reja dhe me këtë rast numri i ngastrës ka ndërruar, pra kjo është arsyeja që ky person ka bërë kërkesë prapë për rishqyrtim të lëndës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua vendimi për miratimin e kërkesës së z. Sabit Halitit nga Podujeva për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, përkatësisht ngastrat kadastrale nr. 607-4, 612-14, 612-5 dhe 612-7 në sipërfaqe prej 0.21.08 m²

5. Të ndryshme

z. Nexhat Llumnica, theksoi, mendoj se ne si Kuvend i Komunës jemi treguar shumë të mëshirshëm me kompaninë KEDS ku i kemi falë pronë publike, kurse kjo kompani është duke u treguar shumë e pamëshirshme me Komunën e Podujevës ku çerdhja e fëmijëve në qytet që tri ditë me radhë është pa energji elektrike si pasoj e shkëputje nga ana e KEDS për mos pagesë, andaj kërkoj që të gjendet zgjidhje rreth kësaj çështjeje në mënyrë që çerdhja të kyçet prapë në rrjetin e energjisë elektrike sepse ata fëmijë kanë nevojë për rrymë e mbi të gjitha për ngrohje.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, në seancën e kaluar kam kërkuar nga drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe atë kërkesë po e përsërisë prapë që në seancën e ardhshme të na deponoi të gjithë këshilltarëve të Kuvendit listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme të Komunës së Podujevës. E thërras drejtorin përkatës se në çoftë se ka diçka që nuk duhet të jetë për publikun atëherë të mos të na ofroj atë, por nëse jo kërkoj ta ketë parasysh këtë kërkesë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, kjo që dua ta ngris është me rëndësi sepse kemi të bëjmë me një vendim të Gjykatës së Apelit për Komunën e Podujevës. Vendimi ka të bëjë me një punëtorë të Komunës e cila është aktiviste e jona – Partisë Demokratike të Kosovës, e larguar nga puna me motive politike. Aktvendimi i Gjykatës është i shkallës së dytë dhe është i formës së prerë dhe se i njëjti e ka miratuar vendimin e shkallës së parë pa të drejtë ankese nga ana e Komunës së Podujevës. Konsideroj se Drejtoritë përkatëse gjegjësisht Komuna ka vepruar shumë keq që nuk e ka kthyer në punë punëtorin Hanëmshahe Berisha. Kërkoj nga Kryetari i Komunës dhe nga drejtorët e Drejtorive përkatëse që të hënë në më 02.03.2015 të thërrasin Hanëmshahe Berishën në vendin e punës ku e ka kthyer Këshilli i Pavarur dhe Gjykata e Apelit në bazë të akt emërimit të vitit

2012, ose për ndryshe, ashtu siç shkruan në aktvendim, ne jemi të detyruar të ngritim kallëzim penal ndaj Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të Drejtorisë përkatëse. Mendojmë se drejtori i Drejtorisë përkatëse dhe Udhëheqësi i Personelit duhet të veprojnë në këtë rast ngase ne si subjekt politikë jemi në dijeni se zyrtarja e lartcekur është larguar nga puna me tendencë vetëm pse e ka mbështetur një subjekt politikë në kohë të fushatës zgjedhore dhe është larguar nga puna pa vendim. Pra ne nuk kemi dashur të ndërmarrim hapa ashtu siç parashihet me aktvendimin përkatës, mirëpo kemi dashur që së pari të kërkojmë nga organet përkatëse të Komunës ta kthejnë në punë të përmendurën dhe nëse një gjë e tillë nuk ndodh ne do të ndërmarrim hapat konform aktvendimit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me çështjen e ngritur nga parafolësi, mendoj se kjo ka të bëjë me organin e pavarur mbikëqyrës dhe me Gjykatat, kështu që kjo çështje u shtrua mirëpo ne si Kuvend i Komunës nuk besoj se mund të ndërhyjmë.

Ju njoftoj se afati i deklarimit të pasurisë është deri më 31 mars 2015, kështu që nga e hëna mund t'i shkarkoni formularët dhe t'i dorëzoni në agjencinë kundër korrupsion deri në atë datë, me siguri se jeni në dijeni por jua rikujtoj se mos deklarimi i pasurisë është vepër penale.

Më nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10;55

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-27499
Podujevë,
27 shkurt 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**